



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve



Nr _____ Prot

Tirane ____/12 /2012

Relacion

Mbi shqyrtimin e aplikimeve te KESH sh.a., TEC Vlore sh.a., OST sh.a., CEZ Shperndarje sh.a., Ulez-Shkopet sh.a., Bistrica1,2 sh.a. per axhustimin e tarifave te gjenerimit, te furnizimit publik me shumice, te sherbimit te transmetimit, te sherbimit te shperndarjes dhe furnizimit me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per Periudhen e Trete Rregullatore (2012-2014)

Bordit te Komisionereve

Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr.21, date 18.03.2009, te ndryshuara, miratoi me vendimet Nr. 140, date 8.10.2012, Nr. 141, date 8.10.2012, Nr. 145, date 26.10.2012, Nr. 146, date 26.10.2012, fillimin e procedurave per shqyrtimin e aplikimeve për axhustimin e tarifave për periudhën e tretë rregullatore te paraqitura nga shoqerite KESH sh.a., KESH sh.a. (FPSH) , OST sh.a., CEZ Shperndarje sh.a.

Ne perputhje me kerkesat e legjislacionit dhe kuadrit rregullator ne fuqi, ERE ka ndjekur nje proces te hapur dhe ka vene ne dispozicion dokumentacionet e aplikimeve per te gjitha palet e interesuara, si dhe ka bere publikimin e ketyre aplikimeve ne faqen zyrtare te internetit te ERE.

Bazuar ne vendimet e siperpermendura per fillimin e procedurave, ERE ndermori nje korrespondence te gjere dhe intensive me keto shoqeri, nepermjet te ciles eshte kerkuar paraqitja e shpjegimeve, te dhenave, informacioneve dhe dokumentave plotesuese lidhur me aplikimet dhe pretendimet e tyre.

Ne mbeshtetje te Rregullave te Praktikave dhe Procedurave te ERE-s, konkretisht te neneve 29 dhe 31 pika 1 dhe 2, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s, Nr.21, date 18.03.2009, te ndryshuar, nga data 30 Tetor deri ne 2 Nentor 2012, midis perfaqesuesve te ERE-s dhe perfaqesuesve te KESH sh.a, OST sha. dhe CEZ Shperndarje sh.a, jane zhvilluar seanca degjimore teknike, ne te cilat ka marre pjese edhe konsulenti i tarifave te USAID-it, lidhur me shqyrtimin e aplikimeve per perditesim te tarifave perkatese.

Nga analiza e aplikimeve te paraqitura nga shoqerite verehet se:

1. Lidhur me aplikimin e KESH sh.a.

1.1. Prodhimi

KESH sh.a. ne daten 26.09.2012, me shkresen 579/1 prot., ka deklaruar nje prodhim neto te pritshem nga burimet e tij gjeneruese per vitin 2012 ne sasine prej 3,897 GWh ose 137 GWh me i madh se sasia prej 3,760 GWh e parashikuar ne

aplikimin e dates 6.09.2012, duke mos ndryshuar keto sasi per vitet 2013, 2014, te cilat jane parashikur te barabarte ne vleren 3,837 GWh per cdo vit.

Ne daten 22.10.2012 ne pergjigje te kerkeses se ERE-s per informacion shtese KESH sh.a. deklaroi nje prodhim neto te pritshem prej 3,639 GWh me justifikimin e perditesimit te bilancit me te dhenat me te fundit. Edhe ne parashikimin e paraqitur ne fund te muajit Tetor 2012, sasite e parashikuara te prodhimit per vitet 2013 dhe 2014 nuk ndryshojne.

Se fundi, ne daten 23.11.2012 KESH sh.a. deklaroi se per vitin 2012 pritet qe prodhimi neto te jete 3,949 GWh nderkohe qe per vitet 2013 dhe 2014 parashikohet qe prodhimi netor te jete perkatesisht 3,393 GWh dhe 3,577 GWh. Ne kete deklarim te fundit vihet re qe kemi nje parashikim ne rritje te prodhimit neto per efekt te llogaritjes se tarifes se gjenerimit per vitin 2012 dhe nje ulje per vitet 2013 dhe 2014.

Keto deklarime te KESH sh.a. pervecse jane kontradiktore me parashikimet e bera ne aplikimin e paraqitur, nga ana e Grupit te Punes gjenden si te pargumentuara dhe jo realiste per faktin se shenojne nje rritje te prodhimit per vitin 2012 dhe nje ulje teper te madhe per vitin 2013 (3837GWh – 3393GWh) dhe 2014 (3837GWh - 3577 GWh).

1.2. Import/Eksport

Shoqeria ka kerkuar qe ne bilancin energjistik te pasqyrohen sasite e energjise te eksportuara dhe importuara per periudhen Janar – Qershor 2012 per sasite 298 GWh eksport dhe 262 GWh import, nderkohe qe nga ana e shoqerise KESH sh.a. te ardhurat nga eksporti nuk jane reflektuar ne reduktimin e te ardhurave te kerkuara per periudhen e rishikuar.

Nga analiza e sasive te energjise se prodhuar nga burimet hidro, importit dhe kerkeses se FPP rezultojne te dhenat si me poshte:

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Total 2012
Prodhim IPP	17,507	16,564	27,988	37,764	44,332	28,105	11,515	8,007	4,186	13,787	209,755
Prodhim HEC-et mesem	41,167	34,622	33,744	44,918	48,057	35,932	19,830	15,738	15,886	17,050	306,944
Gjenerim energjie- KESH	355,590	321,557	182,620	246,127	325,807	493,451	415,755	323,742	390,161	225,241	3,280,051
Humbjet e OST	-16,488	-16,202	-11,455	-11,217	-11,275	-15,320	-15,480	-15,122	-13,216	-11,452	-137,227
Energji e prodhuar per shitje	397,776	356,541	232,897	317,592	406,921	542,168	431,620	332,365	397,017	244,626	3,659,523
Importuar(-) (Eksportuar) (+)	192,000	46,984		23,376	-87,600	-210,176				243,662	208,246
En.totale ne Rrj. e Shpernd	733,972	680,054	596,982	537,950	483,890	489,723	536,890	540,565	469,528	484,706	5,554,260
Shitje CEZ - Klienteve tarifore	315,655	277,756	267,286	293,642	295,791	294,970	292,574	294,542	271,891	312,489	2,916,596
											0
Humbjet ne rrj. e shperndarjes	418,317	402,298	329,696	244,308	188,099	194,753	244,316	246,023	197,637	172,217	2,637,664

Sic shihet nga tabela e mesiperme, e gjithë sasia e importuar e energjise është përdorur për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Prandaj në bilancin e energjise nuk mund të konsiderohet sasia e importuar sepse këto sasi shoqëria KESH sh.a do t'ja faturonte shoqërisë CEZ Shpërndarjes referuar kontratës së furnizimit me energji ndërmjet OSSH dhe FPSH, sic edhe parashikohet në Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.134 datë 17.09.2012 “Mbi kontratën e furnizimit me energji elektrike ndërmjet KESH (FPSH) dhe CEZ Shpërndarje(FPP) për periudhën 01.01.2012-31.12.2014”.

1.3. Shpenzimet operative (OPEX)

1.3.1. Shpenzimet për mirembajtje

Shoqëria në aplikimin e saj të datës 06.09.2012 ka kërkuar një reduktim të këtij zeri shpenzimesh nga 212 milion në 176 milion leke.

Vihet re se shoqëria ka parashikuar për këto ze për vitin 2013 dhe 2014 një rritje prej rreth 6%, ndërkohë që norma e vjetore e inflacionit sipas INSTAT është 2.4%.

1.3.2. Shpenzimet per paga

Shpenzimet per pagat ne aplikimin e dates **6.09.2012** nisur nga te dhenat aktuale te realizimit per 6 mujorin 2012 dhe atij te pritshmit per te gjithë vitin 2012 te paraqitura nga ana e Shoqerise, rezultojne te reduktuara me rreth 15 % (995 milion leke-845 milion leke) kundrejt nivelit te pranuar nga ERE ne tarifen 2012, nderkohe qe per vitin 2013 eshte parashikuar 10% rritje e ketij shpenzimi ndaj nivelit te vitit 2012, dhe per 2014 eshte parashikuar me nje rritje prej 5% kundrejt atij te pranuar per 2013. Nisur nga indeksi i inflacionit referuar te dhenave zyrtare qe deklarohen nga INSTAT dhe Banka e Shqiperise, rritja prej 10% konsiderohet e larte.

1.3.3. Furniturat dhe sherbimet

Per shpenzimet “Furnitura dhe sherbime”, shoqeria ne kerkesen e rishikuar te vitit 2012 ka kerkuar nje vlere prej 679 milion leke nderkohe qe per vitet 2013 dhe 2014 ka parashikuar perkatesisht 717 milion e 753 milion leke. Ky ze shpenzimi parashikohet i njejte me ate te njohur ne tarifen 2012-2014 per cdo vit te kesaj periudhe.

1.4. Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Ne kuader te aplikimit per axhustimin e tarifave shoqeria KESH sh.a ka paraqitur nje plan investimesh me vlere me te vogla per vitin 2012. Plani i investimeve i miratuar per periudhen e trete rregullatore 2012-2014, per vitin 2012 rezulton i perealizuar.

Lidhur me Koston mesatare te ponderuar te kapitalit (WACC) nga analiza e aplikimit dhe nga deklarimet e perfaqesuesve zyrtare te shoqerise ne seancat

degjimore rezulton nje kosto kapitali (WACC) me e ulet se ajo e pranuar ne vendimarrjen e vitit 2011.

2. Lidhur me aplikimin e TEC Vlore sh.a

Nga shqyrtimi i materialeve te derguara nga ana e shoqerise TEC Vlore sh.a., konstatohet se:

1. Aplikimi per tarifen e energjise elektrike per vitin 2013, eshte bazuar ne planin ekonomik-financiar per vitin 2013, plan i cili nuk eshte i miratuar nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise.
2. Shoqeria informon se per shkak te difektit ne sistemin ftohes te centralit ne muajin janar te vitit 2012 dhe ne pamundesi te gjetjes se nje zgjidhje ne afat te tij, impianti aktualisht eshte vene ne regjim konservimi. Ne keto kushte shoqeria ne aplikimin e saj parashikon nje prodhim zero per vitin 2013 nderkohe qe edhe per vitin 2012 rezulton te jete zero.
3. Plani i Biznesit te shoqerise TEC Vlora sh.a parashikon nje numer punonjesish prej 47 personash nga 62 punonjes te parashikuar ne menyre te paargumentuar nga shoqeria.
4. Lidhur me lenden djegese, veme ne dukje se gjate monitorimit u konstatua se nuk kishte nje raport te miratuar nga administratoret e shoqerise TEC-Vlore sh.a. mbi konsumin e lendes djegese dhe konsumin specifik te centralit. TEC-Vlore sh.a rezulton te kete akoma nje rezerve prej 861 milion leke te mbetur nga fondi i njohur ne tarifen e vitit 2010, nderkohe qe ka gjendje ne depozitat e centralit edhe rreth 8,118 mije litra lende djegese me nje vlere prej 824 milion leke, e cila nuk parashikohet te konsumohet per shkak se TEC-i Vlore nuk parashikohet qe te vihete ne pune per vitet 2013 e 2014.

5. Lidhur me sherbimin e mirembajtjes, nga krahasimi i vlerave te pranuar dhe miratuara nga ERE per kete ze shpenzimesh per periudhen 2010-2012 me vlerat e konstatuara nga monitorimi, rezulton nje rezerve pozitive prej **347 milion** leke sic edhe jepet ne tabelen ne vijim:

	Vitet 2010		Vitet 2011		Vitet 2012		2010-2012	
	Vendimi i ERE-s	Realizimi PF	Vendimi i ERE-s	Realizimi 2011 PF	Vendimi i ERE-s	Realizimi PF	Vendimi i ERE-s	Realizimi PF
Blerje materialesh, Furnitura dhe sherbime, Te tjera (siguracion, publikime, pritje e percjellje) (000 leke)	272,659	7,477	59,221	16,097	69,116	30,255	400,995	53,829
							Diferenca	347,167

6. Shpenzime per Sherbimin e Turbinave te Gazit (LTSA). Konstatohet se gjate vitit 2012 nuk ka pasur shpenzim per kete kontrate, ndersa per vitin 2013 ky shpenzim eshte kerkuar ne vleren 81.88 milion leke. Per arsye te difektit teknik per shkak te te cilit impianti planifikohet te mos operoje te pakten per periudhen dy vjecare 2013-2014, parashikohet qe shpenzimi ne lidhje me kete kontrate per vitin 2013 te jete zero leke.

3. Lidhur me HEC Ulez Shkopet, HEC Bistrice 1, 2 dhe HEC Lanabregas

Nga shqyrtimi i materialeve te derguara nga ana e shoqerive HEC Ulez Shkopet sh.a, HEC Bistrice 1&2 sh.a, HEC Lanabregas konstatohet se:

1. Nga te dhenat periodike te raportuara nga keto shoqeri vihet re qe prodhimi aktual dhe ai i pritshmi per vitin 2012, rezulton te jete i njejte me prodhimin e parashikuar ne tarifat e miratuara per keto shoqeri per periudhen 2012-2014.

2. Efektet e inflacionit jane marre parasysh ne llogaritjen cmimit te shitjes se energjise elektrike per keto shoqeri per te tre vitet e Periudhes se Trete Rregullatore 2012-2014.
3. Per vitin 2012 nuk jane evidentuar kosto te tjera shtese te paparashikuara dhe per vitet 2013 dhe 2014 nuk pritet te kete kosto te konsiderueshme qe nuk jane parashikuar ne te ardhurat e kerkuara te shoqërive ne vendimmarrjen e meparshme.
4. Efekti i rivleresimit te asetëve fikse te bera nga shoqerite dhe i kerkuar ne aplikimet e tyre per tu marre ne konsiderate ne llogaritjen e tarifës, nuk merret parasysh ne llogaritjen e RAB-it dhe te kthimit te pranuar mbi te.

4. Lidhur me aplikimin e Furnizuesit Publik me Shumice (KESH Sh.a.)

Nga shqyrtimi i materialeve te derguara nga ana e shoqerise KESH sh.a ne funksionin e saj si Furnizues Publik me Shumice konstatohet se:

1. Ashtu si dhe per te ardhurat e kerkuara per prodhimin publik edhe per aktivitetin e furnizimit me shumice, shoqeria KESH sh.a ka paraqitur disa rillogaritje te te ardhurave te kerkuara per FPSH ne varesi te kerkeses per energji per tu shitur te FPP si dhe te parashikimit per prodhimin e energjise nga KESH Gen.
2. Si pasoje e mosprodhimit nga ana e TEC Vlore, kane rezultuar te reduktuara kostot perkatese te ketij prodhimi te parashikuara ne tarifen e vitit sipas vendimit nr. 145, date 7.12.2011 “Per percaktimin e cmimit te Furnizuesit Publik me Shumice”.

3. Nuk gjenden te argumentuara kostot e overdrafteve te kerkuara nga FPSH, per shkak se rezulton se keto overdrafte jane perdorur per qellime te importit per mbulimin e humbjeve dhe jo per energjine e nevojshme per furnizimin e klienteve tarifore.

Nga analiza e aplikimeve si me siper, eshte arritur ne konkluzionin:

1. Ka paqartesi ne lidhje me prodhimin neto te pritshem te vitit 2012 si dhe ne parashikimin e prodhimit per vitin 2013 dhe 2014.
2. Mos perfshirja e sasise se energjise se eksportuar ne llogaritjen e te ardhurave te kerkuara te shoqerise.
3. Evidentohen rezerva ne te ardhura per shkak te uljes se shpenzimeve operative (OPEX) dhe kapitale (CAPEX) dhe te faktit qe norma zyrtare e inflacionit (CPI) eshte me e ulet se ajo e pranuar ne miratimin e tarifave me vendimin nr.144 date 7.12.2011.
4. Ka paqartesi dhe mosrakordim te kerkeses per energji per furnizimin e konsumatoreve tarifore per vitin 2012.
5. Per vitin 2012 nuk jane evidentuar kosto te tjera shtese per HEC Ulez Shkopet, HEC Bistrice 1&2, HEC Lanabregas, nderkohe qe e njejta gje pritet qe te ndodhe edhe per vitet ne vijim 2013-2014.
6. Duke patur parasysh per TEC Vlore sh.a. ka nje realizim faktik me te ulet te shpenzimeve ne periudhen 2010 - 2011 nga ai i pranuar nga ERE per te njejten periudhe per : shlyerjen e kredive, fondin e lendes djegese dhe shpenzimet per blerje materiale, furnitura e te tjera.

5. Lidhur me aplikimin e OST sh.a.

Nga shqyrtimi i aplikimi te paraqitur nga shoqëria TEC Vlore sh.a., verehet se:

- 1- Ka kontradikta ne parashikimin e sasise se humbjeve ne transmetim. Sipas faturave te leshuara nga KESH sh.a per OST sh.a energjia e humbur ne transmetim rezulton te jete 176 GWh per vitin 2012 nderkohe qe nga parashikimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit ai rezulton 226 GWh.
- 2- Ka nje mosperputhje ndermjet vlerave te investimeve te reja te parashikuara per t'u realizuar ne vitin 2012-2014 ne aplikimin per axhustim te tarifes te cilat rezultojne perkatesisht 7,091 milion leke per vitin 2012, 5,401 milion leke per vitin 2013 dhe 12,858 milion leke ne 2014, ne te cilat perfshihen te gjitha investimet e financuara me fonde te huaja (kontrata huaje te nenshkruara prej vitesh) si dhe me fondet e veta te OST nderkohe qe sipas vendimit Nr.21, date 20.02.2012 te Bordit te Komisionereve "Per miratimin e aplikimit te OST sh.a per ndryshimin e planit te investimeve per periudhen e trete rregullatore 2012-2014" investimet kapitale te planifikuara paraqiten si ne tabelen e meposhtme.

(leke)	Miratuar me Vendimin Nr.21 date 20.02.2012	Aplikuar ne Tarife
2012	9,899,749	7,091,000
2013	8,124,000	5,401,000
2014	3,879,000	12,800,000

Sic verehet nga tabela e mesiperme, ka mospërputhje midis sa aplikuar ne vendimmarrjen e ERE-s me sa eshte aplikuar nga ana e OST ne tarife.

- 3- Ne aplikim llogaritja e amortizimit nuk eshte paraqitur ne kopje elektronike dhe me llogaritje analitike.
- 4- Shpenzimet operative ne te cilat perfshihen shpenzimet e mirembajtjes, personelit dhe per blerje energjie per mbulimin e humbjeve ne transmetim jane kerkuar ashtu si jane miratuar nga ERE ne vendimin nr 146, date 07.12.2011 “ Per miratimin e tarifes se transmetimit per periudhen 2012-2014”, megjithese rezulton se rritja e normes se inflacionit (CPI) eshte ne masen 2.4% sipas INSTAT qe eshte me vogel se ajo e pranuar ne llogaritjen e tarifes per 2012-2014.
- 5- Ne zerin “furnitura dhe sherbime” eshte kerkuar nje rritje prej 170 milion leke nga ajo e miratuar ne tarife si rezultat i rritjes se detyrimit per “pagese per CBT” e cila ne total per vitin parashikohet rreth 3 milion euro. Per vitin 2013 dhe 2014 zeri “furnitura dhe sherbime” paraqitet me nje rritje shume te lehte nga ajo e miratuar ne tarife duke mbajtur ne konsiderate mesataren e viteve te fundit dhe konkretisht per vitin 2013 kerkohet nje vlere prej 530 milion leke nga 519 milion leke qe eshte pranuar ne tarife nderkohe qe per vitin 2014 vlere e kerkuar eshte 540 milion leke nga 538 milion leke.
- 6- Jane realizuar te ardhura nga alokimi i kapaciteteve te cilat sherbejne si rezerve per pagesen e CBT si edhe per investime shtese te nevojshme per fuqizimin dhe zhvillimin e sistemit te transmetimit me qellim shmangjen e kufizimeve ne kapacitetin e interkoneksionit sic edhe parashikohet ne Paketën e Tretë Legjislative të BE-se.

6. Lidhur me aplikimin e CEZ Shperndarje sh.a. per sherbimin e shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice.

6.1. Bilanci elektroenergjitik

Vihet re se ne menyre te perseritur per cdo vit duke filluar nga viti 2009, CEZ nuk dergon tek FPSH dhe te Operatori i Sistemit te Transmetimit, kerkesen per energji elektrike per shitje tek klientet tarifore. Kjo ka bere qe edhe per kete vit aplikimet e te licensuarve per rishikimin e tarifave te ishin ndertuar mbi baza te dhenash te ndryshme. Parashikimi i kerkeses per energji elektrike per vitin pasardhes pergatitet nga CEZ Shperndarje ne funksionin e saj si Furnizues Publik me Pakice, parashikim i cili sherben si baze per parashikimet e kerkeses per Sistemin e Transmetimit dhe te kerkeses se energjise elektrike qe duhet te mbuloje FPSH ndaj FPP-se.

Nisur nga parashikime te ndryshme ne aplikimet e shoqerive nga ana e grupit te punes u organizuan takime te perbashketa me te tre te licensuarit, ne menyre qe te arrihej ne nje kerkese te priteshme te aresyshme dhe sa me afer realitetit. CEZ Shperndarje, pervecse deklaroi ne seancat teknike te dhena te ndryshme nga ato te paraqitura ne aplikimin e dates 3.09.2012, dergoi me shume vonese dhe pertej afateve te kerkuara nga ERE edhe rezultatet e studimit per percaktimin e kerkeses per energjie (date 22.11.2012). Nje vonese e tille nuk u la kohe ne dispozicion te licensuarve te tjere per rishikimin e aplikimeve, por ne te njejten kohe pengoi grupin e punes organizimin e seancave te tjera teknike per te sqaruar cdo detaj te aplikimit, ne perputhje dhe me afatet e percaktuara ne rregullat e praktikes dhe procedurave te ERE-s.

Gjithashtu duhet vene ne dukje se, vecanerisht per sa i takon sasise se energjise elektrike per shitje tek klientet fundore, nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje sh.a

me shkresen nr. 7160/1, Prot., date 22.11.2012, jane paraqitur te dhena te ndryshme nga ato te prezantuara ne seancat teknike duke vene ne pikpyetje besueshmerine e informacionit te paraqitur.

Tabela ne vijim paraqet ne menyre kronologjike ndryshimin e energjise se shitur tek klientet fundore si vijon:

Energjia e faturuar MWH	2011	2012	2013	2014
Aplikimi per perditetim 03.09.12	4,598,507	4,199,334	4,570,551	4,849,534
Kthim pergjigje dt 18.10.12	4,068,200	4,277,515	4,951,551	5,035,534
Séance teknike dt 30.10.2012	4,599,507	3,800,000	4,200,000	4,400,000
Séance teknike dt 02.11.2012	4,599,507	3,690,000	4,160,000	4,431,000
Kthim pergjigje dt 20.11.12 (Nr7160/1)	4,599,507	3,844,881	4,250,670	4,523,256

6.2. Shpenzimet per mbulimin e humbjeve

Nga ana e CEZ per vitin 2012 e per te gjithe periudhen,shpenzimet per mbulimin e humbjeve, jane paraqitur te ndryshme ne varesi te kerkeses per energji te ndryshuar disa here nga ana e shoqerise.

6.3. Shpenzimet operative

Keto shpenzime shoqeria i propozon te rishikuara ne perputhje me rekomandimin e Panelit Rishikues bazuar ne shpenzimet aktuale te gjysmes se pare te vitit 2012 si dhe duke konsideruar projektet “e transformimit” kostot e te cilave nuk u njohen nga ERE ne tarifat e periudhes 2012-2014.

Ne lidhje me kete kerkese, grupi i punes pas analizes se dokumentacionit te derguar nga kompania, megjithese me vonese, konstaton perseri se kompania

bazohet ne nje kerkese pershkruese te sherbime apo projekteve qe mendon se do te realizoje, pa shoqeruar me analiza te kosto/perfitim.

Materialet, kontratat e derguar me 30.11.2011 pervec pershkrimit te tipit te sherbimit nuk paraqesin asnje llogaritje apo kostot perkatese per cdo sherbim. Jane paraqitur vetem pagesat si dhe permbledhsja e tyre, por nuk ka asnje detajim kostoje sipas natyres se tyre dhe per njesi.

Megjithse kompania ne ankimin e saj pretendon se ERE ka fiksuar te gjitha shpenzimet operative OPEX per te gjitha vitet e periudhes se trete rregullatore, ashtu sic kemi shpjeguar me pare, perserisim se keto shpenzime jane percaktuar duke marre per baze shpenzimet e viti baze 2012 duke i indeksuar me normen e pranuar te inflacionit 4 %. Nese do te perditesonim llogaritjen e OPEX per viti pasardhes duhet te konsiderojem se sipas parashikimit te INSTAT, OPEX duhet te korigjohet ne zbritje (4%-2.4%) me 1.6%.

6.3 Investimet

Megjithese investime jane komponent fiks i te ardhurave te kerkuara dhe qe ndjeshem nuk jane realizuar, kompania e ka mbajtur te pandryshuar ne llogaritjet e saj per perditeseimin e tarifes 2012-2014. Kompania deklaroi se ka kapitalizuar 669 milion leke deri ne Gusht te viti 2012 dhe nuk paraqiti te dhena ne lidhje me realizimin e priteshem deri ne fund te vitit .

6.4 Amortizimi

Verehet se kompania nuk ka paraqitur vleren e amortizimit te llogaritur per asetet qe jane ne pune, duke reflektuar mosrealizimin e investimeve te reja te parashikuara per vitin 2011 nga 2,395 milion leke ne ne 1,947 milion leke si dhe per vitin 2012 nga 6500 milion leke ne 669 milion leke.

Mbas shqyrtimit te kujdesshem te te gjithë elementeve perberes te kerkeses se shoqerise CEZ Shperndarje, perfshire ketu edhe sqarimet e marra nepermjet informacionit plotesues si dhe atyre te bera ne seancat teknike, grupi i punes vlereson se:

- 1- Shoqeria ka paraqitur te dhena dukshem te ndryshme dhe me shume vonese dhe kjo ka penguar qartësimin e treguesve dhe ka bere kerkesa te paargumentuara.
- 2- Ne vendimet e ERE per miratimin e tarifave per periudhen e trete rregullatore 2012 - 2014, jane marre ne konsiderate efektet e mundshme te inflacionit per te ardhurat e kërkuara kompanive jane llogaritur me te larta se sa ato qe kane rezultuar faktikisht, sipas INSTAT.
- 3- Aktualisht ERE ka nisur procedurat e heqjes se licences per mospërmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit ne fuqi, detyrime te cilat afektojne treguesit e performancës dhe ne menyre te veçante humbjet dhe arketimet. Kjo situatë e veshtireson dhe me teper vendimmarrjen e ERE-s ne lidhje me tarifen e energjise per vazhdimesine e kësaj kompanie ne vitet qe vine sipas treguesve perkates.

Duke u bazuar ne konkluzionet e nxjerra me siper per Kompanite KESH sh.a, OST dhe CEZ Shperndarje sh.a propozojme lenien ne fuqi deri ne date 30 qershor 2012, te tarifave te miratuara perkatesisht me vendimet si me poshte :

- Vendimin nr. 144, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifës se prodhimit te energjise elektrike nga KESH sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 87, date 29.06.2012 “Per rishikimin e tarifës per Furnizuesin Publik me Shumice per Periudhen e Trete Rregullatore per akomodimin e

efekteve financiare te vendimit Nr.80 date 15.06.2012 te Bordit te Komisionereve te ERE-s”.

- Vendimin nr. 151, date 7.12.2011 Per percaktimin e cmimit te shitjes te energjise elektrike te prodhuar nga TEC Vlore sh.a. tek FPSH, per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 152, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Bistrice 1,2 sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 153, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Lanabregas sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 154, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Ulez Shkopet sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 146, date 7.12.2012 te Bordit te Komisionereve “Per miratimin e tarifes se transmetimit te energjise elektrike nga OST sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin Nr.147, date 07.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se shperndarjes te energjise elektrike per periudhen e trete rregullatore 2012-2014 dhe Nr.148 date 07.12.2011 “Per percaktimin e cmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per periudhen e trete rregullatore”.

7. Lidhur me percaktimin e cmimit te shitjes te energjise elektrike per hec-et egzistuese me fuqi te instaluar deri ne 10 MW dhe te rinj me fuqi deri ne 15 MW.

Duke qene se llogaritja e cmimit te energjise elektrike te prodhuara nga kjo kategori hec-esh perdor inpute te tarifes se Furnizuesit Publik me Shumice dhe Pakice, dhe keto keto cmime jane te transferueshme dhe si te tille do te ndikojne ne te ardhurat e kerkuara per Furnizuesin Publik me Shumice (KESH /FPSH) te cilat si kemi propozuar me siper do te kalkulohen ne nje kohe tjeter atehere propozojme qe te lihen ne fuqi :

- Vendimi Nr.149 date 07.12.2012 “Per percaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW per vitin 2012” .
- Vendimi Nr. 150 date 07.12.2012 “Per percaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet egzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per vitin 2012”.